

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 235 Prot.

Tiranë, më 31.03 2015

VENDIM Nr. 30, datë 26.03.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 4, të datës 26.03.2015, pasi shqyrtoi raportin e paraqitur mbi "Kërkesë për gërmimin arkeologjik të shpëtimit", në një sipërfaqe afërsisht 10 m², në afërsi të fshatit Xhyherinë të Vlorës, në kuadër të projektit "Vija bregdetare e qytetit Vlorë"-FSHZH, paraqitur nga arkeolog i licensuar z. Gjergj Frashëri,

VENDOSI:

- I. Miratimin e raportit të paraqitur nga arkeolog i licensuar z. Gjergj Frashëri, për zonën në fshatin Xhyherinë të Vlorës ku merret materiali që shërben për mbushjen e plazhit, në kuadër të projektit "Vija bregdetare e qytetit Vlorë"-FSHZH, sipas të cilit nga vëzhgimi dhe sondazhi kuadratik i kryer nga ai në prani të dy arkeologëve të DRKK-së Vlorë, nuk u hasën gjurmë dhe asnjë mundësi për të takuar njësi apo objekt arkeologjik, në kontekst dokumentar.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO